

REPUBLIKA E KOSOVËS	REPUBLIKA KUOSVA	REPUBLIC OF KOSOVO
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	AGENCE PRÉTIVE CONTRE LA CORRUPTION	ANTI-CORRUPTION AGENCY
Dok.	Dok.	Dok.
Nr. Fiq.	01	Nr. Prot.
Pro. marrja		Bz. Prot.
		Prot. No.
		Date
		16.01.2012
		Prishtine

Nr.regj. 37296/2011

GJYKATA KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË, duke vendosur në procedurën për kundërvajtje kundër të pandehurit Rifat Krasniqi nga fshati Mamushë, Komuna Prizren, për kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik e Pasurisë, Nr. 03/L-151, në bazë të nenit 73,74, 195,199 të Ligjit mbi Kundërvajtjet GZ KSAK 23/79, me datë **31.12.2011** merr këtë:

A K T V E N D I M

I PANDEHURI: **Rifat Hysen Krasniqi**, i lindur më 1910.12.1962 në Mamushë, Komuna Prizren, ku edhe tani jeton, me profesion pedagog, i punësuar si Zëvendës Ministër në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, i martuar, babë i katër fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike,

Ë sh t ë P ë r gj e gj ë s

Sepse, si Zyrtar i Lartë Publik, në pozitë të Zëvendës Ministrit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, nuk e ka dekluar gjendjen e pasurisë në Agjencinë Kundër Korrupsion, brenda afatit ligjor prej 60 ditësh pas marrjes së detyrës në qershori të vitit 2011,

- me çka ka kryer kundërvajtje nga neni 7 paragrafi 1 e ndëshkuar me nenin 16 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për Deklarimin, Prejardhjen dhe Kontrollin e Pasurisë dhe Dhuratave të Zyrtarëve të lartë Publik, andaj të pandehurit për këtë kundërvajtje i shqiptohet,

D Ë N I M I

Me gjobë në shumë prej **200 € (dyqind euro)** të cilën shumë i pandehuri është i obliguar ta paguaj në afat prej 15 ditësh, pasi që ky aktvendim të merr formë e prerë, në llogarinë e të hyrave gjyqësore të KGJK-së No.1000 4300 7000 0518. Pagesa bëhet në ndonjëren agjenci për mbledhjen e të hyrave-bankë, përmes urdhërpagjes së plotësuar nga Gjykata. Nëse gjobën e shqiptuar nuk e paguan në afatin e dhënë, e njëjta do të zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **13 ditësh**, duke llogaritur nga 15 Euro për një ditë burgimi.

Shpenzime të procedurës nuk ka pasur, kurse në emër të paushallit gjyqësor i pandehuri është i obliguar të paguaj shumë prej **5 Euro** në shërbimin e arkës së gjykatës.

Nga një kopje e këtij aktvendimi i dërgohet parashtruesit të kërkesës dhe të pandehurit

A r s y t i m

Agjencia Kundër Korrupsionit në Prishtinë, i parashtroi kësaj gjykate Kërkesën 01-4098/11 me datë 26.10.2011 për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit të lartshënuar për kundërvajtjen e precizuar si në dispozitiv të këtij aktvendimi, meqë i njëjti nuk e ka dorëzuar në Agjencinë kundër Korrupsion formularin mbi deklarimin e gjendjes së pasurisë brenda afatit ligjor prej 60 ditësh nga marrja e detyrës.

Në bazë të kërkesës së parashtruar, gjyqtarja filloj procedurën kundërvajtëse, mori në pyetje të pandehurin i cili në mbrojtjen e vet deklaroi se e pranon kundërvajtjen e cila i vihet në barrë duke shtuar se nuk konteston asgjë, vetëm se për shkak të angazhimeve të shumta në zyrë i kishte dalur nga mendja afati i fundit për deklarimin e pasurisë, mirëpo këtë gjë e kishte bërë me vonesë, gjatë vitit por nuk din saktë datën, siç thotë me siguri AKK disponon me të dhëna precise. Në vazhdim i pandehuri shton se nuk

Kishte pasur qëndrimin që ti shmanget deklarimit të pasurisë, ngase edhe më herët kishte mbajtur poste të zyrtarit të lartë edhe çdo herë e kishtë bërë deklarimin e pasurisë. Kësaj deklarate gjyqtarja ia falë besimin, ngase me datë 31.12.2011 verifikoi nga zyrtari Afrim Atashi, kompetent nga divizioni për antikorruption në AKK, se vërtete i pandehurit ka bërë deklarimin e pasurisë më vonësë, saktësisht me datë 01.11.2011, andaj gjyqtarja këtë fakt e konsideroi si rrethanë lehtësuese.

Nga të dhënat në kërkesë, vlerësimi i deklaratës së të pandehurit, administrimi i provave dhe shqyrtimi i shkresave të tjera të lëndës, gjyqtarja në masë të mjaftueshme vërtetoi gjendjen e plotë faktike, ekzistimin e veprës kundërvajtëse dhe përgjegjësisë së të pandehurit për këtë kundërvajtje, andaj të njëjtin e dënoi me dënimin e paraparë ligjore.

Gjatë shqiptimit të dënit të gjyqtarja pati parasysh rrethanat nga neni 7 i LK në të cilat është kryer kundërvajtja dhe duke vlerësuar masën e shkeljes sipas pozitës së zyrtarit të lartë publik si dhe personalitetin e tij, të njëjtit ia shqiptoi dënimin me gjobë të precizuar si në dispozitiv, me bindje se edhe me një gjobë të tillë do të arrihet qëllimi i ndëshkimit dhe se i pandehuri në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e ndonjë kundërvajtjeje të tillë apo të ngjashme.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

U VENDOS NË GJYKATËN KOMUNALE PËR KUNDËRVAJTJE NË PRISHTINË
Nr.regj.37296/2011, datë 31.12.2011

Gjyqtarja
Suzana Cerkini

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 8 ditësh pas pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Lartë për Kundërvajtje në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate, pa taksa.